

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6581
E shtunë, 9 prill 2022
çmimi 0.40 €

Aksioni "Pika 2", 26 zyrtarë policorë të arrestuar për ryshfet



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FEDERATAT DHE SHOQATAT SINDIKALE KËRKOJNË MIRATIMIN E LIGJIT TË PAGAVE

SINDIKATAT PARALAJMËROJNË GREVË NGA 20 PRILLI



Federatat dhe Shoqatat Sindikale kanë protestuar të premtën në Prishtinë dhe kanë kërkuar miratimin e Ligjit të Pagave, zbatimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore dhe ndryshimin e Ligjit për Skemat

Pensionale. Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, At dhe Hykollli, para protestuesve ka thënë se janë lodhur duke pritur zbatimin e këtyre ligjeve. Ndërkaq kryetari i Sindikatës së Bashkuar të

Arsimit, Shkencës, Kulturës, Rrahman Jasharaj, ka thënë se nëse nuk merren parasysh kërkesat e kësaj sindikate, nga 20 prilli punëtorët e arsimit do të hyjnë në grevë, e për këtë fajtor, sipas tij, është kryeministri Kurti

Slovakia i dhuron Ukrainës sisteme të mbrojtjes ajrore S-300



REFORMA NË ARSIM, QËNDRON KASTRATI FITON NË KUSHTETUESE PËRBALLË MASHTI-T

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



BRITANIA SANKSIONON VAJZAT E PUTINIT F. 2

QEVERIA E MALIT TË ZI VENDOS SANKSIONE NDAJ RUSISË F. 3

KOSOVA E PARA NË VLERËSIMIN E EIONET PËR RRJEDHËN E TË DHËNAVE PËR VITIN 2021 F. 7

EKONOMI



SHTRENJTOHEN MATERIALET NDËRTIMORE F. 8

MALLRAT NË SHQIPËRI, 5.7 PËR QIND MË TË SHTRENJTA NË MARS

F. 8

SPORT



BALLKANI NË KLINË E VAZHDON RRUGËN DREJT TITULLIT F. 10

Slovakia i dhuron Ukrainës sisteme të mbrojtjes ajrore S-300

BRATISLAVË, 8 PRILL - Kryeministri i Sllovakisë, Eduard Heger, ka thënë se shteti i tij i ka dhuruar Ukrainës sisteme të mbrojtjes ajrore S-300, që janë prodhim sovjetik.

Këto komente ai i bëri gjatë vizitës në kryeqytetin ukrainas, Kiev, ku

së bashku me zyrtarë të tjerë të Bashkimit Evropian, më 8 prill u takuan me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky.

Zelensky më herët ka kërkuar këso lloj sistemesh, teksa ka biseduar muajin e kaluar me ligjvënësit amerikanë. Ai ka bërë

thirrje që t'i dhurohen sistemet S-300 pasi, sipas tij, do t'i lejojnë Ukrainës që ta "mbyllë qiellin" për avionët luftarakë dhe raketat ruse. Anëtarët e NATO-s, Bullgaria, Sllovakia dhe Greqia, kanë sisteme S-300, të cilat mund të hedhin raketa me qindra

kilometra larg dhe mund të rrezojnë raketa dhe avionë luftarakë.

Më herët Sllovakia kishte deklaruar se ishte e gatshme t'i jepte Ukrainës sistemet S-300, por me kusht që ato t'i kompensoheshin.



BE-ja miraton pakon e pestë me sanksione kundër Moskës

BRUKSEL, 8 PRILL - Bashkimi Evropian ka miratuar pakon e pestë të sanksioneve kundër Rusisë për luftën e saj të paprovokuar kundër Ukrainës. Në mesin e sanksioneve përfshihen ndalesa në importin e thëngjillit dhe mbylljen e porteve të bilokut evropian për anijet ruse. "Bashkë me katër pakot e tjera, këto sanksione do ta shtojnë presionin ekonomik ndaj Kremlinit dhe do ta vështirësojnë aftësinë për ta financuar pushtimin e Ukrainës", ka thënë blloku evropian përmes një deklarate më 8 prill. "Këto masa janë më të gjera dhe më të ashpra, ashtu që të kenë ndikim edhe më shumë në ekonominë ruse. Ato janë krijuar në koordinim me partnerët

ndërkombëtarë", është thënë në deklaratë, duke shtuar se janë duke u përgatitur sanksione shtesë ndaj Moskës.

Sanksionet e reja shënjestrojnë gjashtë sektorë: thëngjillin, transaksionet financiare, transportin, importin dhe eksportin në Rusi dhe përjashtimin e Rusisë nga kontratat publike dhe fondet evropiane.

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët evropianë kanë vënë sanksione të ashpra ndaj Rusisë prej nisjes së luftës në Ukrainë.

Synimi është që Moskë të izolohet në aspektin ekonomik, financiar dhe diplomatik.

Këto sanksione janë përgjigje ndaj të dhënave për mizori të kryera nga trupat ruse.



Steinmeieri kërkon tribunal për krime lufte për Putinin dhe Lavrovin



BERLIN, 8 PRILL - Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, tha se duhet të krijohet një tribunal për krime të luftës kundër presidentit të Rusisë, Vladimir Putin dhe kryediplomatit rus Sergei Lavrov, teksa dëshmi të reja po dalin për mizoritë që pretendohet se janë kryer nga forcat ruse në Ukrainë.

Në një intervistë për revistën gjermane "Der Spiegel", të publikuar më 8 prill, Steinmeier tha se "kushdo që është përgjegjës për këto krime duhet

të japë shpjegime". "Kjo përfshin edhe ushtarët, komandantët e ushtrisë dhe natyrisht ata që kanë përgjegjësi politike", tha ai.

Shumica e fokusit është përqendruar në krimet e pretenduara të luftës të kryera në Buça, qytet në afërsi të Kievit. Forcat ruse janë tërhequr nga qyteti më 1 prill dhe më pas janë publikuar pamje të civilëve të vrarë, disa prej të cilëve me duar të lidhura pas shpine, të shtrirë në rrugët e këtij qyteti. Banorët e Buças kanë thënë se

kanë qenë dëshmitarë të vrasjeve brutale dhe torturave dhe, po ashtu, janë publikuar të dhëna për varreza masive.

Udhëheqësit ukrainas kanë thënë se zbulime të tilla do të bëhen sapo ta rimarrin kontrollin e qyteteve të pushtuara nga forcat ruse.

Akuzat për mizoritë e kryera nga forcat ruse u rritën më 8 prill, pasi raketat ruse goditën një stacion treni në lindje të Ukrainës, duke vrarë të paktën 30 persona dhe plagosur mbi 100.

Britania sanksionon vajzat e Putinit

LONDËR, 8 PRILL - Britania e Madhe ka shtuar vajzat e presidentit rus Vladimir Putin në listën e sanksioneve. Britania ka thënë se me këtë vendim synon ta shënjestrojë përditshmërinë e atyre që janë në rrethin e ngushtë të Putinit.

Pas pushtimit rus të Ukrainës, Britania dhe disa vende aleate të Perëndimit kanë vendosur një mori sanksionesh, duke shënjestruar elitat e pasura të

Moskës, industritë kyçe dhe qasjen në sistemin financiar ndërkombëtar.

Në një përditësim të listës së sanksioneve janë shtuar edhe vajzat e Putinit, Yekaterina Tikhonova dhe Maria Vorontsova.

Në listë është përfshirë edhe Yekaterina Vinokurova, vajza e ministrit të Jashtëm rus Sergei Lavrov.

Të tria janë sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara gjatë

javës. "Pakoja jonë e pashembullt e sanksioneve është duke goditur elitën dhe familjet e tyre, si dhe po dëmton ekonominë ruse në nivel që Rusia nuk e ka parë prej rënies së ish-Bashkimit Sovjetik", ka thënë sekretarja e jashtme britanike, Lizz Truss. Britania e Madhe vlerëson se 60 për qind e rezervave valutore ruse janë ngrirë si pasojë e sanksioneve ndërkombëtare.



Reforma në arsim, Qëndron Kastrati fiton në Kushtetuese përballë MASHTI-t

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 PRILL - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka hedhur poshtë vendimin e Ministrisë së Arsimit për organizimin e mësimin alternativ të përsheptuar dhe përcaktimit të organizimit të mësimin në objektet shkollore në komunën e Kamenicës. Gjykata ka theksuar se MASHTI-i përmes vendimit "ka tejkaluar kompetencën dhe ka cenuar përgjegjësitë komunale, përkatësisht ka ndërhyrë në kompetencat vetjake të komunës së Kamenicës përkitazi me ofrimin e arsimit publik, në kundërshtim me garantitë kushtetuese dhe ligjore". Gjykata theksoi tutje se ofrimi i arsimit publik bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje lokale është kompetencë vetjake e komunës dhe se këto kompetenca "janë të plota dhe ekskluzive", dhe se në rolin e saj inspektues, të përcaktuar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, MASHTI "mund ta kërkojë zbatimin e mësimin shtesë ose alternativ" nëse vërehet mangësi në zbatimin e kurrikulumit. Por, gjykata shpjegon se në rastin konkret, MASHTI, duke nxjerrë



vendim konkret, kishte organizuar mësim alternativ në pesë shkolla në Kamenicë, shkolla që paraprakisht kryetari i atëhershëm i komunës, Qendron Kastrati, i kishte riorganizuar përmes vendimeve si pjesë e reformës së tij. Rasti ndërlihej me riorganizimin e

shkollave në komunën e Kamenicës më 2019, që ishte iniciuar përmes vendimit të kryetarit të komunës (Qendron Kastrati) me arsyetimin e rënies së numrit të nxënësve në disa shkolla dhe mungesës së infrastrukturës së mirëfilltë të institucioneve arsimore.

Por, me pakënaqësinë e disa prindërve të nxënësve të afektuar që refuzuan zbatimin e vendimeve të komunës, më 2021 MASHTI formoi një komision për vlerësimin e mosvijueshmërisë së mësimin nga ana e 441 nxënësve, ku kishte rekomanduar që për ta adresuar

situatën, MASHTI dhe komuna duhet: (i) ndërmarrin veprime të harmonizuara; dhe (ii) të themelojnë grup punues për analizimin e situatës në shkolla.

Megjithatë, MASHTI nxori vendimin e kontestuar, në të cilin organizoi "mësimin alternativ të përsheptuar për 441 nxënësit e komunës së Kamenicës". Vendimin e kontestoi komuna e Kamenicës duke pretenduar se ministria kishte ndërhyrë në kompetencat vetjake të komunës.

Gjykata më pas, më 8 prill 2022, doli me vlerësim prej disa pikash prej të cilave thuhej se organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj, se komunat kanë kompetenca vetjake dhe se rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën dhe ligjin. Në vazhdim, gjykata theksoi nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit, komunat kanë kompetenca "të plota dhe ekskluzive" në ofrimin e arsimit publik, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin etj.

Qeveria e Malit të Zi vendos sanksione ndaj Ruisë



PODGORICE, 8 PRILL - Pas disa shtyrjeve, Qeveria e Malit të Zi ka miratuar më 8 prill sanksione kundër Ruisë për shkak të sulmit të paprovokuar kundër Ukrainës. "Sapo është miratuar një paketë masash kufizuese kundër Ruisë! Faleminderit të gjithë ministrave për bashkëpunimin!", ka thënë zëvendëskryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović, përmes një postimi në "Twitter".

Pas vendimit për vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë, institucionet qeveritare duhet t'i ngrijnë pronat dhe burimet ekonomike të disa shtetasve dhe kompanive ruse në Mal të Zi dhe ta ndalojnë punën e medieve qeveritare ruse. Hapësira ajrore

malazeze ishte e mbyllur më parë për avionët rusë, sepse vendimi formal i qeverisë nuk ishte i nevojshëm për atë vendim. Për shkak të mungesës zyrtare të kryeministrit Zdravko Krivokapiq, seancën e së premtes e ka drejtuar Abazović. Më 1 mars Mali i Zi në mënyrë deklarative iu bashkua sanksioneve të miratuara nga Bashkimi Evropian kundër Ruisë, por qeveria e kryeministrit Zdravko Krivokapiq shmangu marrjen e një vendimi që ato të mund të zbatoheshin në praktikë.

Qeverisë së kryeministrit Zdravko Krivokapiq iu dha votë mosbesimi në fillim të shkurtit të këtij viti dhe deri më tani nuk është zgjedhur

kryeministër i ri. Brenda qeverisë janë dy rryma të kundërta në mandatin teknik, të drejtuar nga kryeministri Krivokapiq dhe zëvendëskryeministri Abazović. Abazović këmbënguli që qeveria të miratojë një vendim për zbatimin e sanksioneve ndaj qytetarëve rusë që janë në listën e zezë të Bashkimit Evropian, derisa Krivokapiq propozoi formimin e një "trupi koordinues për ta monitoruar futjen dhe zbatimin e masave ndërkombëtare për kriza në Ukrainë".

Në seancat e kaluara të qeverisë nuk ka pasur përkatje të mjaftueshme nga ministrat për miratimin e ndonjë propozimi. Ambasadorja amerikane në Maltë Zi,

Judy Rising Reinke, e ka përgëzuar Qeverinë e Malit të Zi për marrjen e vendimit për sanksione: "Bravo! E rëndësishme të shohësh që vendi aleat, Mali i Zi, u është bashkuar sanksioneve të Bashkimit Evropian, të cilat janë të krijuara për t'i zvogëluar aftësitë e Ruisë që ta financojë luftën e saj jonjerëzore dhe të paprovokuar ndaj popullsisë së Ukrainës".

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara i kanë bërë vazhdimisht thirrje Malit të Zi që t'i zyrtarizojë sanksionet kundër Ruisë.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Mal të Zi njoftoi më 7 prill se i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, mori garanci nga kryeministri Krivokapiq se Mali i Zi do të miratonte

sanksione.

Më 7 mars Qeveria e Ruisë e përfshiu Malin e Zi në listën e vendeve të huaja që "kryen veprime armiqësore kundër Ruisë, personave juridikë dhe fizikë rusë". Lista përfshin edhe anëtarët e Bashkimit Evropian, përfshirë Slloveninë dhe Kroacinë, si dhe Shtetet e Bashkuara, Australinë, Britaninë e Madhe, Kanadanë dhe të tjerë.

Më 24 shkurt presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar atë që e konsideron "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënues në shumë vende të botës.



FEDERATAT DHE SHOQATAT SINDIKALE KËRKOJNË MIRATIMIN E LIGJIT TË PAGAVE

Sindikatat paralajmërojnë grevë nga 20 prilli

Federatat dhe Shoqatat Sindikale kanë protestuar të premten në Prishtinë dhe kanë kërkuar miratimin e Ligjit të Pagave, zbatimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore dhe ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale. Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykolli, para protestuesve ka thënë se janë lodhur duke pritur zbatimin e këtyre ligjeve. Ndërkaq kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës, Kulturës, Rrahman Jasharaj, ka thënë se nëse nuk merren parasysh kërkesat e kësaj sindikate, nga 20 prilli punëtorët e arsimit do të hyjnë në grevë, e për këtë fajtor, sipas tij, është kryeministri Kurti

PRISHTINË, 8 PRILL - Miratimi i Ligjit të Pagave, zbatimi i Ligjit për Sigurime Shëndetësore dhe ndryshimi i Ligjit për Skemat Pensionale janë tri kërkesat e Federatave dhe Shoqatave Sindikale të Kosovës të cilat të premten kanë protestuar në Prishtinë. Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykolli, para protestuesve ka thënë se janë lodhur duke pritur zbatimin e këtyre ligjeve. "Pritëm dhe mund të presim për të mirën e Kosovës sonë, por nuk mund ta durojmë shpërfilljen dhe mospranimin e dialogut social dhe mosrespektimin e profesionalizmit tonë. Çmimet kanë kapur majat, e pagat trinë aty ku ishin, dhe kjo vetëm për punëtorët, sepse të tjerët nuk e kanë keq. Falë djersës së punëtorëve jetojnë si në përralla, por së shpejti do të përrallosen. Për këtë besoj dhe shpresoj fort", ka

deklaruar Hykolli para protestuesve. Ndërkaq kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Rrahman Jasharaj, i cili ka marrë pjesë në protestë, ka thënë se qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti është shembulli më i keq i heshtjes dhe i mungesës së gatishmërisë për dialog. Jasharaj ka theksuar se nëse

nuk merren parasysh kërkesat e kësaj sindikate, nga 20 prilli punëtorët e arsimit do të hyjnë në grevë, e për këtë fajtor, sipas tij, është kryeministri Kurti. "Këta punëtorët të arsimit nga 20 prilli do t'i shohësh në grevë dhe populli le ta dijë se fajtori i vetëm është kryeministri Kurti dhe qeveria e tij. Në të ardhmen do të jemi këtu,



sepse është sheshi ynë, në të ardhmen do të jemi në shkollë, por do të jemi në grevë", është shprehur Jasharaj.

Ligji 'i pezulluar' i Pagave

Projektligji për Paga, që parasheh rritje të pagave në bazë të koeficientit, apo detyrave që kanë punonjësit publikë, ka mbetur pezull që nga viti 2020. Ky ligj ishte miratuar në shkurt të vitit 2019 dhe kishte hyrë në fuqi në mars të po atij viti. Por, Avokati i Popullit e kishte dërguar këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të përputhshmërisë së tij me Kushtetutën e vendit. Më 2020 Gjykata Kushtetuese nxori vendimin dhe tha se ky legjislacion nuk ishte në përputhje me 11 nene të Kushtetutës dhe se shkaktonte "çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura", duke e shfuqizuar vendimin e Kuvendit të Kosovës. Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se janë në proces të rihartimit të këtij projektligji dhe i njëjti pritet të dërgohet në Kuvend gjatë muajit prill. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), protestuesit do të kërkojnë që deri në zbatimin e Ligjit të Pagave të ketë rritje të pagave për

100 euro për punëtorët e sektorit publik. Kjo pasi, siç kanë thënë më herët sindikalistët, në Kosovë në muajt e parë të vitit 2022 janë rritur çmimet e konsumit, duke bërë që inflacioni në muajin shkurt të arrinte në 7.5 për qind.

Ligji i 'harruar' i Sigurimeve Shëndetësore

Policët e zjarrfikësit janë ndër punëtorët në profesione që konsiderohen me rrezik, e të cilët punojnë pa sigurime shëndetësore. Ndërsa një numër i vogël i qytetarëve në Kosovë përmes kompanive private paguajnë për sigurime shëndetësore, pasi në vend nuk zbatohet Ligji për Sigurime Shëndetësore. Një ligj i tillë ishte miratuar më 2014, por asnjëherë nuk është zbatuar për askënd. Zbatimi i ligjit ishte parashikuar që t'i paraprinte një periudhë gjashtëmuajore për mbledhjen e fondeve. Mbledhja e fondeve ishte paraparë që të niste më 1 korrik të vitit 2017. Atëbotë ishin ndarë nga Qeveria e Kosovës 17 milionë euro, derisa më pas ishin tërhequr për t'u orientuar në një destinacion tjetër, përkatësisht për pagesat e pensioneve për veteranët e luftës.

Joachim Hoppe merr mandatin e drejtorit të ri të NALT-it

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Në Ministrinë e Mbrojtjes të premtën është mbajtur ceremonia e transferimit të autoritetit të drejtorit të Ekspertit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, respektivisht drejtorit në shkuarje, gjeneralit Jorg Ruter te drejtori në ardhje i NALT-it, gjeneralit Joachim Hoppe. Enkas për këtë ceremoni e pranishme ishte edhe shefja e Operacioneve Aktuale në Divizionin e Operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm të NATO-s, Ariella Viehe, autoritet ky të cilit i subordinohet NALT-i. Me këtë rast, të pranishmëve të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë me fjalime iu djretuan Viehe, ministri Mehaj, gjeneral Ruter dhe gjeneral Hoppe.

Viehe dhe Mehaj vlerësuan lart leadershipin e gjeneralit Ruter gjatë mandatit të tij, në cilësi të drejtorit të NALT-it.

Ministri Mehaj ka folur për rezultatet konkrete të arritura në fusha të ndryshme në funksion të ndërtimit dhe zhvillimit të

vazhdueshëm të kapaciteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ndërkaq në fjalën e tij, gjeneral Ruter ka shprehur përshtypjet më të mira për të arriturat e deritashme të ministrisë dhe të FSK-së, nivelin e lartë të bashkëpunimit të tij me ministrin Mehaj dhe gjeneral Jasharin, si dhe gjithë stafin të tij me autoritetet e tjera vendore.

Në vazhdim Viehe, ministri Mehaj dhe gjenerali Jashari i dhanë medalje zyrtare gjeneralit Ruter, me motivacionin më të lartë për shërbimin e shquar, leadershipin profesional dhe angazhimin vetëmohues.

Në fund, pas pranimit të autoritetit, të pranishmëve iu drejtua gjeneral Hoppe, i cili shprehu gatishmërinë e tij dhe vullnetin e plotë për t'i vazhduar sukseset e pararendësit të tij. Gjithashtu, ai ka theksuar se bashkëpunimi i mirë dhe sistematik në mes ekipit të tij dhe autoriteteve të Ministrisë dhe FSK-së do të jenë prioritet kryesor gjatë mandatit të tij.



Prej atëherë çështja e sigurimeve shëndetësore ka mbetur pezull.

Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, në programin për zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit të vitit 2021 - zgjedhje në të cilat fitoi mbi 50 për qind të votave - kishte thënë se "funktionalizimi i sigurimeve shëndetësore publike është detyrë e jona për të cilën zotohem para jush se do të përmbushet". Por, deri më tani ekzekutivi kosovar i udhëhequr nga Albin Kurti nuk ka

marrë ndonjë vendim për jetësimin e këtij ligji.

Kontributet pensionale

Kërkesa e tretë e sindikalistëve është që të ndryshohet Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht të ndryshohet neni ku kërkohet që të ketë 15 vjet kontribute pensionale para 1 janarit të vitit 1999. Para këtij viti të gjithë qytetarët që kanë pasur kontribute pensionale, të njëjtat

nuk iu figurojnë pasi Serbia që nga përfundimi i luftës ende nuk i ka kompensuar ato kontribute ndaj qytetarëve të Kosovës.

Sipas ligjit aktual të pensioneve, çdo person që mbush 65 vjet, e që ka qenë kontributpagues, duhet ta dëshmojë pagesën e kontributeve para datës së vitit 1999. Nëse nuk arrijnë të dëshmojnë se kanë pasur kontribut 15 vjet para 1 janarit të vitit 1999, ata nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit kontributpagues, por vetëm marrin

pensionin e moshës. Buxhetit të Kosovës skemat sociale dhe pensionale brenda një viti i kushtojnë 43.3 milionë euro.

Vlera më e madhe shkon te pensionet bazike të moshës apo 14.9 milionë. Kjo kategori merr pagesë prej 100 eurosh në muaj. Ndërkaq, në kategorinë e pensionit kontributpagues të moshës, vlera varion në bazë të nivelit të shkollimit.

Në kategorinë e parë hyjnë pensionistët e parsimuar ose ata me

arsim fillor dhe pensioni është në vlerë prej 182 eurosh. Ata me arsim të mesëm marrin 198 euro në muaj, pensionistët me arsim të lartë marrin pension prej 214 eurosh në muaj dhe pensionistët me arsim universitar paguhen 265 euro. Në Kosovë ka edhe skema të tjera pensionale dhe sociale, përfshirë edhe pensionet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Forcave të Sigurisë së Kosovës, të punëtorëve të kompleksit "Trepça" e të tjerë. (rel)

Komuna e Kamenicës po bëhet me park teknologjik

KAMENICË, 8 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit në vlerë prej 204 881.35 eurosh për bashkëfinancimin e projektit për parkun teknologjik me ministrin e Zhvillimit

Rajonal, Fikrim Damka. Kryetari Rahimaj ka thënë se nëpërmjet këtij projekti do t'u japin mundësi të rinjve të komunës së Kamenicës dhe jo vetëm, që të aftësohen e përgatiten në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

“Ky projekt, gjithashtu, do të mundësojë hapjen e vendeve të reja të punës si dhe gjenerimin e ideve të reja biznesore në këtë fushë. Ky është veç fillimi i projekteve të mëdha dhe i punëve të mira”, ka thënë Rahimaj.



QKMF-ja ‘Dr. Nexhat Çuni’ në Mitrovicë furnizohet me material mjekësor stomatologjik



MITROVICË, 8 PRILL (ER) - Pas një kohe të gjatë të mungesës së materialit të nevojshëm për punë, Sektori i Shëndetit Oral i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” i Mitrovicës është furnizuar me një kontingjent me material mjekësor stomatologjik në vlerë prej 13 000.00 eurosh, të financuara nga buxheti komunal i destinuar për QKMF-në.

Derisa furnizimi i të gjithë sektorëve të tjerë të QKMF-së ka filluar më herët dhe tanimë është normalizuar plotësisht, Sektori i Shëndetit Oral kishte mbetur i vetmi sektor pa furnizim me medikamente dhe materiale mjekësore të nevojshme për punë. Kjo vonesë, sipas Drejtorisë së Shëndetësisë, ka ndodhur për shkak të procedurave të stërzgjatura ankimore si pasojë e mungesës së bordit të OShP-së në

nivelin qendror.

Drejtorja e Shëndetësisë ka njoftuar qytetarët se prej javës së ardhshme do të mund t'i marrin shërbimet e nevojshme stomatologjike, që ofrohen në Sektorin e Shëndetit Oral në QKMF dhe QMF-të e AMF-të që ofrojnë shërbimet stomatologjike (Iliridë, Vaganicë, Bajr 2, Shipol, Tunel i Parë, Gushac dhe Bare).

Përveç furnizimit me materiale mjekësore, drejtori i Shëndetësisë, Fahri Shabani, ka potencuar se janë duke punuar intensivisht në procesin e shpalljes së konkursit për punësim të specialistëve, mjekëve, infermierëve dhe profileve të tjera të punëtorëve shëndetësorë për ta plotësuar mungesën e madhe të kuadrit mjekësor në QKMF, QMF-të dhe AMF-të e Kujdesit Parësor Shëndetësor të komunës së Mitrovicës.

Komuna e Drenasit dhe Oda e Hotelerisë nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

DRENAS, 8 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim kryetarin e Odës së Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës (OTHK), Hysen Sogojeva. Ky i fundit ka uruar kryetarin Lladrovci për mandatin e ri të fituar, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të palodhshme. Po ashtu, Sogojeva ka ofruar bashkëpunim me komunën e Drenasit e

cila u finalizua me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet dy palëve. Kryetari Lladrovci ka falënderuar për gatishmërinë e Odës së Hotelerisë dhe Turizmit në Kosovë për ta bashkëpunuar me komunën e Drenasit, me ç'rast renditi mundësitë e bashkëpunimit me këtë institucion.



Vendpunishtja te ish-Shkolla e Muzikës në Prishtinë, lokacion i rrezikshëm

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit në Prishtinë, Florian Dushi, bashkë me drejtorin e Drejtorisë për Investime Kapitale, Krenar Xh. Xhaferi, kanë vizituar të premtën lokacionin - vendpunishten te ish-Shkolla e Muzikës në Prishtinë. Me këtë rast, duke e konsideruar si lokacion të rrezikshëm (i

mbetur i tillë për gati tetë vjet) për banorët dhe nxënësit që vijojnë mësimin në shkollën “Elena Gjika” e cila është aty afër, është vendosur që të merren masa urgjente për ta siguruar lokacionin deri në vendimin përfundimtar te komuna e Prishtinës lidhur me të ardhmen e këtij ndërtimi.



Kryetari i Skenderajt bën homazhe te varri i dëshmorit Ejup Behrami

SKENDERAJ, 8 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, së bashku me familjarë,

përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, drejtorët e komunës dhe asamblastë, ka nderuar të

premtën në Prekaz të Epërm sakrificën e dëshmorit Ejup Behrami, në 23-vjetorin e rënies së

tij në altarin e lirisë. “Lavdi të gjithë heronjve dhe martirëve të Kosovës!”, ka thënë Nura.

Osmani dekoron pesë ushtarakë të Brigadës së UÇK-së 138 'Agim Ramadani'

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në prag të përvjetorit të betejës së Koshares, të premtën ka dekoruar me Medalje Presidenciale post mortem pesë ushtarakë të Brigadës së UÇK-së 138 "Agim Ramadani".

Sipas propozimit të përfaqësuesve të Brigadës, presidentja Osmani për trimërinë e dëshmuar gjatë betejës së Koshares dhe kontributin pas luftës ka dekoruar ushtarakët: Adem Dahri, Afrim Beka, Arben

Sejdiu, Faik Gashi dhe Skënder Rexhëahmetaj. Dekoratat u janë dhënë familjarëve të luftëtarëve në praninë e komandantëve të Brigadës 138.

Presidentja Osmani ka çmuar kontributin e luftëtarëve të UÇK-së për lirinë dhe pavarësinë e vendit dhe ka theksuar se liria e Kosovës mban emrin e secilit prej tyre. "Ndihej e nderuar që në këtë përvjetor të lavdishëm si presidente dekoroj me medalje pesë luftëtarë të shquar të Brigadës 'Agim Ramadani'.

Kontributi dhe sakrificat e tyre do të jenë udhërrëfyes për brezat dhe tregues i vlerës së lirisë që e gëzojmë", është shprehur presidentja Osmani.

Familjarët kanë falënderuar presidenten Osmani dhe kanë thënë se kjo dekoratë ka vlerë të veçantë në këtë përvjetor të betejës së Koshares. Manifestimi kushtuar përvjetorit të 23-të të betejës së Koshares pritet të mbahet të shtunën (9 prill) nën përkujdesjen e presidentes Osmani.



Aksioni "Pika 2", 26 zyrtarë policorë të arrestuar për ryshfet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 PRILL - Policët kufitarë kanë qenë përsëri cak i një aksioni të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës.

IPK-ja ka njoftuar se në orët e hershme të mëngjesit të së premtes ka filluar një operacion të gjerë, të koduar me emrin "Pika 2", që i ka paraparirë një hetimi rreth njëvjeçar.

Inspektorati Policor, në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale, kanë arrestuar 26 zyrtarë policorë në pikëkalimin kufitar në Vërmicë, nën dyshimin për kryerjen e veprave penale: marrje ryshfeti dhe keqpërdorim i detyrës zyrtare.

Në mesin e të arrestuarve janë dy rreshterë dhe 24 zyrtarë policorë. Aksioni është kryer pas dyshimeve për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme të një numri të zyrtarëve policorë lidhur me veprat penale "marrje e ryshfetit" dhe "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". "Ky hetim është zhvilluar në koordinim të plotë dhe nën udhëheqjen nga Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) duke përfshirë edhe masa të fshehta të hetimit. Hetimi përfshin edhe bashkëpunim me

prokurorë nga SPAK-u [Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e Republikës së Shqipërisë] dhe zyrtarët e AMP-së, Agjencisë për Mbikëqyrje Policore (agjencia homologe e IPK-së në Shqipëri)", është thënë në njoftimin e IPK-së, duke theksuar se me autorizimin e Prokurorisë Speciale në kuadër të këtij hetimi nga hetuesit e IPK-së janë përfshirë edhe masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit si dhe masat e nevojshme që të zbulojnë dhe të ruajnë gjurmët dhe provat e tjera të veprave penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova të cilat mund të përdoren në procedurë penale. "Bazuar në këto veprime të suksesshme hetimore, IPK në kuadër të operacionit 'Pika 2' ka arrestuar sot 26 zyrtarë policorë (duke përfshirë dy rreshterë policorë dhe 24 zyrtarë policorë), që të gjithë të dyshuar për veprat penale 'keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar' 'marrje e ryshfetit'", është theksuar në njoftimin e Inspektoratit.

Ndërkohë, sipas njoftimit të SPAK-ut, gjatë hetimeve janë dokumentuar 312 raste të dyshimeve për vepra korruptive të punonjësve të policisë, të cilët favorizojnë persona të ndryshëm për kalim të kundërligjshëm të



kufirit.

Në njoftimin e SPAK-ut thuhet se në këtë aksion janë ndaluar si të dyshuar 32 punonjës të Policisë Kufitare në Kukës, përfshirë edhe drejtorin e kësaj drejtorie, për kryerjen e veprave penale "Shpërdorim i detyrës", "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", "bashkëpunim", "Ushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike". Gjykata në Shqipëri ka shqiptuar

masën e arrestit në burg për 17 punonjës të dyshuar të policisë, në arrest shtëpiak për 14 persona të dyshuar dhe janë pezulluar nga detyra tre punonjës policie si të dyshuar.

Në gjysmën e muajit të kaluar Policia e Kosovës arrestoi 48 policë dhe 2 doganierë në komunën e Gjakovës dhe të Prizrenit, nën dyshimet për veprat penale "marrje e ryshfetit" dhe "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Ata u arrestuan në pikat kufitare në Qafë-Prush dhe Morinë, pika këto që lidhin Kosovën me Shqipërinë.

Disa prej tyre dyshohen për marrje të ryshfetit me qëllim që t'u mundësonin qytetarëve të ndryshëm kalimin e kufirit në mënyrë të kundërligjshme.

Dyshohet se ata kanë marrë qindra euro si ryshfet nga qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë. Pas arrestimit, atyre u është caktuar masa e paraburgimit.

Kosova e para në vlerësimin e EIONET për rrjedhën e të dhënave për vitin 2021

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Kosova përmes Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit ka shënuar përparimin më të madh deri më tani në historinë e raportimit në Rrjetin Evropian për Informim dhe Vëzhgim EIONET.

Agjencia e Mjedisit të Evropës ka publikuar vlerësimin parafinal për rrjedhën e të dhënave në EIONET për vitin 2021. Krahasuar me vlerësimin paraprak, Kosova ka shënuar sërish përparim në procesin e raportimit duke përmbyshur 100 % të obligimeve të planifikuara për raportim për këtë vit, dhe i prinë listës së vendeve që kanë përmbyshur

këtë obligim raportues.

Në kuadër të vlerësimit për këtë periudhë, për gjashtë fusha relevante të raportimit, Kosova ka marrë pikët maksimale për secilën nga fushat e raportimit, përkatësisht për raportimin e të dhënave vjetore për cilësi të ajrit, raportimin online të të dhënave për cilësi të ajrit, raportimin për emisionet në ajër, raportimin për gazrat serrë, raportimin për zonat e mbrojtura, raportimin për cilësi të ujërave dhe raportimin për sasi të ujërave.

Viti 2021 shënon vitin me përparimin më të madh në historinë e raporteve në


EIONET/EEA, që ka realizuar Kosova përmes AMMK, nga viti 2011 (57 %), viti 2018 (60 %), viti 2019 (67 %) dhe viti 2020 (89 %).

Kysukses është arritur falë punës dhe përkushtimit të ekspertëve të AMMK dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera monitoruese në nivel kombëtar, si dhe mbështetjes nga donatorët përmes projekteve të ndryshme.

Njëherë ky sukses tregon edhe përkushtimin e AMMK për përmbyshjen e detyrimeve tona në raport me Agjencinë e Mjedisit të Evropës dhe në procesin e integrimi evropiane.

Eionet core data flows 2021

The provisional scores presented below are based on 11 out of 11 data flows evaluated for 2021.



Shtrenjtohen materialet ndërtimore

Prishtinë, 8 prill - Çmimet e materialeve ndërtimore, krahas çmimeve të konsumit, kanë shënuar ngritje të konsiderueshme. Këto ngritje janë shfaqur sidomos pas fillimit të luftës në Ukrainë. Këtë e thonë shitësit e materialeve ndërtimore. Madje ata tregojnë se shtrenjtimi i materialeve ndërtimore ka ndikuar edhe në shitjen e tyre. “Është e vërtetë që ka ngritje të çmimeve, kryesisht 40-50 % nëse krahasohet me vitet paraprake. Kjo ka ndodhur si pasojë e luftës në Ukrainë. Kryesisht hekuri, blloqet, çimentot që të gjitha janë ngritur 40 deri 50 %. Ne kryesisht punojmë me ndërtime të ulëta dhe tani nuk ka interesim nëse bëjmë krahasim me vitet paraprake”, ka theksuar për RTK-në, Fitim Sopjani, shitës i materialeve ndërtimore.

Sipas kryetarit të Shoqatës së Ndërtuesve, çmimet e materialeve ndërtimore përcaktohen në bursa, prandaj nuk mund të ndikojnë. “Nuk është hera e parë që ka ngritje të



çmimeve të materialit ndërtimor sepse edhe para 12 vjetëve i kemi pasur të njëjtat çmime të hekurit dhe çimentos, mirëpo ndërtimi nuk është ndalur dhe po vazhdon, por

normalisht ka ngritje të çmimit të banesave sepse në bazë të një analize del që kostoja e ndërtimit është rritur deri 35 %, derisa çmimet e banesave janë rritur diku 20 % në raport me

vitin e kaluar”, është shprehur Faton Hoxha, kryetar i Shoqatës së Ndërtuesve. Duke marrë si bazë kryeqytetin, në Drejtorinë e Urbanizmit për tremujorin e parë të këtij viti

janë bërë më shumë kërkesa për leje ndërtimi krahasuar me vitin paraprak të së njëjtës periudhë. Ngritjes së çmimeve u janë bashkuar edhe ato të ndërtimit.

Policia kufitare parandalon një rast të kontrabandës në kufi



PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Njësisia Task-Forcë e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare-Lindje, në kuadër të Planit Operativ “Goditja 2022”, në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e paligjshmërisë, kanë shtuar kontrollin taktik dhe operacionale në terren. Si rezultat i kësaj, sot rreth orës 11:30, bazuar edhe në analizën e riskut dhe informacioneve inteligjente të bëra nga ana e njësisë të policisë kufitare, është arritur të identifikohen një kamion ngjyrë i kaltër, me targa vendore, drejtuar nga i dyshuari me iniciale M. M., shtetas i Kosovës. Malli i kontrabanduar dyshohet se ishte futur në territorin e Republikës së Kosovës nga

Republika e Maqedonisë Veriore përmes rrugëve ilegale. “Pas tentativës së tyre për t’iu shmangur ndalimit policor, autoritetet tona kufitare kanë arritur ta ndalojnë rreth orës 11:30 në fshatin Kabash të Vitisë. Gjatë kontrollit në automjet është gjetur sasi e konsiderueshme e mallrave të ndryshme komerciale si pjesë makinash, gjera ushqimore (lajthi), barna stimuluese ‘kamagra’ etj. Vlera e totale e mallit mbetet të vlerësohet nga ana e Doganës së Kosovës. Me këtë rast është duke u marrë Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare Lindje në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe Doganën e Kosovës”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Çmimet në Shqipëri, 5.7 për qind më të shtrenjta në mars

TIRANË, 8 PRILL - Çmimet kanë shënuar rritje të ndjeshme në muajin mars, duke shtrenjtuar koston e jetesës për të gjitha familjet shqiptare, që mesatarisht 42 % të shpenzimeve i çojnë për ushqime, sipas anketës së buxhetit të familjeve.

Pothuajse gjithçka ka qenë shumë më e shtrenjtë në mars, që nga ushqimet deri te karburantet. Të vetmet që nuk janë shtrenjtuar janë shërbimet arsimore dhe ato shëndetësore,

sipas raportit të Institutit të Statistikave INSTAT të publikuar të premten. Inflacioni, apo Indeksi i Çmimeve të Konsumit, në muajin mars arriti nivelin rekord prej 5.7 %.

Duke marrë parasysh serinë e raportimeve të INSTAT, rritja e inflacioni në mars rezultoi më i lartë që prej vitit 2002 dhe është shumë më i lartë se objektivi prej 3 % i Bankës së Shqipërisë. Rritja vjetore e çmimeve në muajin mars është ndikuar

kryesisht nga ushqimet dhe pijet joalkoolike me një rritje prej 3.31 pikë përqindjeje, ndjekur nga çmimet e transportit me një rritje prej 1.08 pikë përqindjeje.

Rritja e ndjeshme e çmimeve pritet ta përkeqësojë dukshëm situatën financiare të familjeve shqiptare. Pjesa më e madhe e tyre kanë deklaruar si asnjëherë tjetër se presin një përkeqësim të situatës financiare të familjeve të tyre gjatë 12 muajve të ardhshëm.



Një grusht shteti kundër Putinit: Një mendim i dëshiruar apo një mundësi reale?

Nga Oleg SUKHOV
"Kyiv Independent"

Shërbimet sekrete ukrainase kanë pretenduar se po përgatitet një grusht shteti kundër diktatorit rus Vladimir Putin. Megjithatë pretendime të tilla mund të jenë të dyshimta, analistët mund të vlerësojnë mundësinë e një grushti shteti, duke pasur parasysh situatën ekonomike dhe politike në Rusi.

Disa prej tyre thonë se një grusht shteti ndaj Putinit ka shumë pak gjasa të ndodhë, ndërsa të tjerë gjykojnë se ky skenar është pothuajse i pashmangshëm, për shkak të vendimit të presidentit rus për të nisur një sulm ushtarak të paprecedentë kundër Ukrainës.

Mbështetja për Putinin në Rusi është ende e lartë, ashtu si edhe për pushtimin e tij në Ukrainë, ndërsa sanksionet perëndimore nuk e kanë shkatërruar ende ekonominë ruse. Nuk ka shumë njerëz të aftë që ta rrëzojnë Putinin apo që dëshirojnë ta bëjnë këtë në rrethin e tij të ngushtë.

Për më tepër një grusht shteti ndaj Putinit është jashtëzakonisht i rrezikshëm. Gjithsesi gjasat për një skenar të tillë mund të rriten nëse lufta kundër Ukrainës bëhet jopopullore në Rusi, dhe nëse Kremli pëson disfatë të mëdha në Ukrainë. Në këtë skenar mund të kontribuojë edhe përkeqësimi i mëtejshëm i situatës ekonomike. "Putini është shndërruar në një simbol, dhe kur njerëzit të zhgënjehen me simbolin, i gjithë sistemi do të shembet. I gjithë sistemi është i fokusuar tek ai"- thotë analisti politik rus Dmitry Oreshkin për "Kyiv Independent". Shërbimi sekret ushtarak i Ukrainës, deklaroi më 20 mars se në Rusi po organizohet një grusht shteti. "Në elitën ekonomike dhe politike ruse, po shfaqet një grup njerëzish me ndikim që e kundërshtojnë Vladimir Putinin. Synimi i tyre është ta rrëzojnë sa më shpejt të jetë e mundur Putinin, dhe të rivendosin lidhjet ekonomike me Perëndimin që u shkatërruan si rezultat i luftës kundër Ukrainës"- thuhet në deklaratë.

Më tej theksohej se një pjesë e elitës ruse po konsideron emrin e Alexander Bortnikov, kreut të Shërbimit Federal të Sigurisë (FSB), si një pasardhës të mundshëm të Putinit. Gjithnjë sipas raportit, diktatori rus është i pakënaqur me Bortnikov për shkak se FSB i ka dhënë atij informacione të pasakta për Ukrainën, të cilat çuan edhe në



dështime të mëdha ushtarake. Por Genadi Gudkov, një kolonel në pension dhe ish-drejtor i FSB-së, që është shndërruar në një kritik të ashpër të Putinit, është skeptik mbi këto të dhëna. "Ky është vetëm një mendim i dëshiruar. Çdo grusht shteti përgatitet në një mjedis shumë të fshehtë. Nëse është e vërtetë, njerëzit mësojnë për të pasi ka ndodhur"- deklaroi Gudkov më 24 mars për kanalën televizive "Current Time".

Një nga parakushtet kryesore për një grusht shteti, është një ndarje e dukshme në elitën politike. Sanksionet e vendosura ndaj Rusisë për agresionin e saj kundër Ukrainës dhe izolimin e saj në rritje nga bota e jashtme, kanë shkaktuar tashmë pakënaqësi tek një pjesë e establishmentit rus.

Anatoli Chubais, një figurë politike më shumë peshë, që i kishte shërbyer për dekada Putinit dhe paraardhësit të tij, Boris Yeltsin, dha dorëheqjen nga pozicioni i ndihmësit të presidentit rus dhe u largua nga vendit. Arkady Dvorkovich, ish-zëvendëskryeministër dhe kreu i Federatës Ndërkombëtare të Shahut, e ka kritikuar luftën kundër Ukrainës dhe ka dhënë dorëheqjen si kreu i Fondacionit Skolkovo, një qendër e teknologjisë së lartë e financuar nga shteti.

Kundër luftës janë shprehur edhe oligarkët rusë, të cilët kanë ndjekur gjithmonë linjën e Kremlinit ose kanë heshtur mbi çështjet politike. Manjatët Mikhail Fridman, Alexei Mordashov dhe Vladimir Lisin e kanë quajtur luftën një tragjedi, dhe kanë bërë thirrje për paqe. Manjati i aluminit Oleg Deripaska e ka quajtur luftën një

"çmenduri", që do të turpërojë rusët për disa breza. Analistët politikë rusë Oreshkin dhe Georgy Satarov, thanë se deklaratat e oligarkëve tregojnë një ndarje të qartë në elitën politike.

"Oligarkët e kanë menduar prej kohësh idenë e një grushti shteti. Putin është aq toksik dhe i rrezikshëm sa që ata do të preferonin zëvendësimin e tij. Por ata kanë frikë të flasin për këtë sepse do të vriteshin"- thotë Gudkov.

Por Sergei Sazonov, një filozof politik me origjinë ruse në Universitetin Tartu në Estoni, mendon se oligarkët nuk luajnë asnjë rol në sistemin politik të Putinit, në kontrast me zyrtarët e lartë të shërbimeve sekrete dhe të zbatimit të ligjit.

Një faktor tjetër kryesor që do të përcaktojë të ardhmen e Putinit është mbështetja popullore.

Agresioni i Rusisë kundër Ukrainës dhe propaganda e dhunshme shtetërore në televizionet e kontrolluara nga Kremli, duket se e kanë rritur mbështetjen për Putinin në mënyrë të ngjashme me aneksimin e Krimesë në vitin 2014.

Numri i atyre që mendojnë se Rusia po lëviz në drejtimin e duhur u rrit nga 52 për qind në shkurt në 69 për qind në mars, sipas një sondazhi nga agjencia ruse e sondazheve Levada. Edhe vlerësimi për punën e Putinit u rrit nga 71 për qind në shkurt në 83 për qind në mars.

Sipas një sondazhi të veçantë të Levadas më 4 prill, 65 për qind e të anketuarve ndejnë krenari, lumturi ose eufori për shkak të luftës kundër Ukrainës, dhe 31 për qind kanë ndjenja negative

për të.

Oreshkin beson se ky sondazh pasqyron tendencat e vërteta. Por Satarov tha për "Kyiv Independent" se edhe sondazhet në dukje të pavarura në një diktaturë nuk pasqyrojnë realitetin, sepse të anketuarit e mbështesin Putinin nga konformizmi dhe jo nga besimi i tyre i sinqertë.

Popullariteti i Putinit mund të bjerë, sapo më shumë njerëz të nisin të ndërjegjësohen për vdekjet e ushtarëve rusë në Ukrainë dhe ndërsa situata ekonomike do të përkeqësohet më tej, thotë Oreshkin. "Sa më gjatë të vazhdojë lufta, aq më keq për Putinin"- thekson ai.

Satarov gjykon se ndjekja penale e krimeve të luftës të Rusisë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare mund të inkurajojë elitën ruse të rrëzojë Putinin.

"Ata do ta paraqesin Putinin si fajtorin kryesor, dhe do ta portretizojnë veten si shpëtimtarë të vendit"- thotë ai. Aktualisht përmendet edhe një paralelizim me Luftën e Parë Botërore. Në vitin 1914, mbështetja ndaj luftës në Perandorinë Ruse ishte e pamasë, por në vitin 1917 zhgënjimi me luftën ishte aq i madh sa që çoi në përmbysjen e monarkisë.

Ndërkohë a janë të mundshme protestat? Oreshkin thotë se janë të mundshme protestat në shkallë të gjerë si rezultat i luftës dhe krizës ekonomike. Por ai shton se vetëm protestat nuk kanë gjasa ta rrëzojnë Putinin. Ai përmendi shembullin e protestave të mëdha të vitit 2020 në Bjellorusi dhe Khabarovsk Krai të Rusisë, të cilat dështuan sepse nuk pati një përçarje të elitës.

Por Oreshkin tha se protestat mund të kontribuojnë në përmbysjen e Putinit duke i inkurajuar komplotistët e mundshëm, dhe duke e bërë më të realizueshëm një grusht shteti. Nga ana tjetër: A është e pamundur ndodhja e grushti shteti?

Agresioni i Putinit kundër Ukrainës është krahasuar shpesh me fillimin e Luftës së Dytë Botërore nga Adolf Hitleri. Rreth 40 komplete të pasuksesshme për vrasje u organizuan kundër Hitlerit, me më të famshmin nga koloneli i ushtrisë gjermane Claus von Stauffenberg më 20 korrik 1944.

Por disa analistë dyshojnë se ekziston një "Stauffenberg" në Rusi. Sergei Pugachyov, bankier dhe ish-bashkëpunëtor i Putinit që tashmë është në përplasje me të, deklaroi më 1 prill se rrethi i brendshëm i Putinit e mbështet sulmin ndaj Ukrainës.

Edeh Gudkov thotë se lufta ka shumë mbështetje brenda FSB-së dhe një grusht shteti do të ishte jashtëzakonisht i rrezikshëm. "Çdo dyshim për tradhti ose intriga mund të çojë në vdekje"- thotë ai. Edhe Sazonov gjithashtu beson se një grusht shteti nuk ka gjasa të ndodhë. Sistemi politik rus mbetet i qëndrueshëm nga brenda, dhe ekonomia deri më tani ka pësuar më pak dëme se sa pritej.

Ai thekson se në kontrast me Wehrmacht-in e Gjermanisë naziste, ushtria ruse është e paaftë të organizojë një grusht shteti. Si autoritetet sovjetike po ashtu edhe ato ruse kanë shmangur emërimin në krye të ushtrisë të njerëzve të pavarur, ambiciozë dhe kompetentë, për shkak të frikës se ushtria mund të rrëzonte qeverinë.

Nëse do të ndodhë një grusht shteti, ai ka më shumë gjasa të organizohet nga zyrtarë të Shërbimit Federal të Sigurisë (FSB), i cili është relativisht më kompetent dhe më i pavarur se agjencitë e tjera, tha ai. Çdo komplot duhet të përfshijë gjithashtu punonjës të Shërbimit Federal të Mbrojtjes (FSO), sepse ata mbrojnë Putinin dhe kjo është mënyra e vetme për t'u afruar me të.

Marrë me shkurtime

Shënim: Oleg Sukhov, gazetar rus i transferuar në Ukrainë në vitin 2014 për shkak të shtypjes së mediave të pavarura në Rusi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ballkani në Klinë e vazhdon rrugën drejt titullit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 PRILL - Sot (e shtunë) do të zhvillohen dy ndeshje të javës së 28-të në BKT Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra lidere në tabelën e klasifikimit pas tri pikëve të fituara në tavolinë nga ndeshja me Gjilanin, i shkon Dukagjinit në Klinë me synim për të marrë edhe tri pikë të reja dhe për të vazhduar rrugëtimin drejt titullit kampion. Mirëpo kjo ndeshje s'do të jetë e lehtë aspak për skuadrën nga Suhareka për faktin se Dukagjini është në garë për mbijetesë dhe kërkon

maksimumin nga kjo ndeshje. Ndërkohe Gjilani pas humbjes se tri pikëve në tavolinë ndaj Ballkanit pritet t'i rikthehet fitoreve në ndeshjen ndaj Drenicës, e cila poashtu ak treguar formë të mirë në këtë edicion. Të dielën Prishtina në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret Malishevën. Fitorja është synim i kryeqytetasve të cilët kanë mbetur pas skuadrave kryesuese në renditjen tabelore, e në anën tjetër Malisheva që drejtohet nga Arsim Thaqi do të mundohet të marrë rezultat pozitiv për të qenë me e qetë në ndeshjet e fundit të kampionatit. Llapi pësoi humbje në gjysmëfinale

të Kupës nga Prishtina në ndeshjen e parë, kurse të dielën i shkon Ulpianës. Edhe kjo e fundit ka nevojë për pikë dhe do të luftojë maksimalisht. Në këtë xhiro më të lehtë pritet ta këtë Drita që përballet me Feronikelin në Drenas.

SUPERLIGA - Java e 28

Të shtunën takohen:
14:00 Gjilani - Drenica
14:00 Dukagjini - Ballkani

Të dielën takohen:
14:00 Prishtina - Malisheva
14:00 Ulpiana - Llapi
14:00 Feronikeli - Drita



Sonte përballen Trepça - Bashkimi, nesër zhvillohen dy ndeshja të tjera



PRISHTINË, 8 PRILL - Xhiroja e 26 në Art Motion Superligë është hapur me ndeshjen në mes të Yllit dhe Dritës, ku fitues kanë dalë therandasit, duke regjistruar fitoren e 20. Ndërsa sot do të zhvillohet ndeshja e rivalëve të vjetër në mes të Trepçës dhe Bashkimit. Mitrovicasit renditen në vendin e dytë me 17 fitore e tetë humbje, kurse prizrenasit janë në vendin e shtatë me dhjetë fitore e 15 humbje.

Ndeshje shumë interesante pritet ndërmjet Prizrenit 16 dhe Pejës, vendit të katërt, përkatësisht të tretë. Prizrenasit kanë 15 fitore e dhjetë humbje, ndërsa pejanët 16 fitore e nëntë humbje, andaj pritet një sfidë rivalizuese, me të dyja skuadrat që synojnë një pozitë sa më të lartë në garat e rregullta. Ndeshja e fundit zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Sigal Prishtinës, skuadrës së gjashtë, përkatësisht të pestë në

renditje. "Vreshtarët" kanë 11 fitore e 14 humbje, kurse prishtinasit 12 fitore e 13 humbje.

SUPERLIGA - Java 26

Të shtunën takohen:
20:30 Trepça - Bashkimi

Të dielën takohen:
17:00 Prizreni 16 - Peja
20:30 Rahoveci - Sigal Prishtina

Presidenti i KOKSh-it: Të hapen bastet, sporti të marrë një përqindje nga taksat

TRANË, 8 PRILL - Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSh), Fidel Ylli, i pezmatuar nga buxheti i qeverisë për sportin, të premtën ka zhvilluar një mbledhje me Ministrinë e Sporteve dhe propozimi i tij është hapja e basteve sërish dhe një pjesë e të ardhurave që mbledhen nga taksat të shkojnë për sportin. "Ne duam që këto para t'i kontrollojë qeveria, jo Federata, as KOKSh-i, por vetë qeveria, sepse mbledh të ardhura jo vetëm për sportin.

Janë miliona euro, e dinë të gjithë. Ato para të shkojnë për sportin, për këta kampionë që janë këtu me mua që e kanë nderuar Shqipërinë. Ne patëm një mundësi që na dhanë 200 milionë lekë Ministria për në Olimpiadë dhe ne ua akorduar sportistëve tanë që të stërviten dhe me ato stërvitje dhanë rezultat, me një kampion bote dhe dy medalje të tjera në stilin e shkëputjes në Uzbekistan", ka thënë Ylli. "Ne nuk duam që t'i nxjerrim atletët tanë që me trofetë dhe me

medaljet e tyre të bëjnë grevë përpara kryeministrit, por ta sensibilizojmë qeverinë dhe kryeministrin. Janë miliona lekë që i ka krimi. Të gjithë e dimë dhe asnjë nuk flet. Ato para më pas të bëhen qendra olimpikë, sepse sporti nuk është një garë, por cilësi jete. Nuk mjaftojnë stadiumet e reja dhe zyrat, sepse nuk më duhen zyrat e KOKSh-it dhe projekti 5 milionë euro nëse këto projekte nuk balancohen me buxhetet e federatave", u shpreh Ylli.



Broja mungon ndaj Chelseat

Southampton, 8 prill - Southamptoni pret Chelsea në sfidën e javës së 32-të të Premier Ligë, por sulmuesi i vendasve, Armando Broja, nuk

do të mund të luajë në këtë takim. Ajo që e ndalon djalosin shqiptar është rregullorja në Premier Ligë, e cila thekson se një lojtar që

jepet huazim në një skuadër tjetër të kampionatit, nuk mund të luajë kundër skuadrës e cila zotëron ende kartonin e futbollistit, në këtë rast Chelsea.

Broja do të jetë një mungesë e madhe për Southampton në këtë sfidë të vështirë në kampionat, kundër njëres prej ekipeve më të mira në Angli.

Kumbulla, pas humbjes nga Bodo/Glimt: Vështirë të luash në fushë sintetike

ROME, 8 PRILL - Bodo/Glimt i shkaktoi Romës një tjetër humbje, por këtë herë të vlefshme për duelin e parë të çerekfinaleve. Mbrojtësi Marash Kumbulla ishte në fushë nga minuta e parë, por nuk mundi që ta shmange disfatën e verdhekuqve, që erdhi edhe nga

gabimet e portierit Rui Patricio. "Të vjen keq për golin e dytë që pësuam, sepse ndeshja thuajse kishte mbaruar. Bëmë një pjesë të parë të mirë, ndërsa në pjesën e dytë na mungoi përqendrimi dhe nuk ditëm ta menaxhonim mirë situatën. Duhet të luajmë si në 45

minutat e para, ku krijuam shumë raste dhe rrezikuam fare pak në mbrojtje", ka thënë Kumbulla. "Tani mendojmë për ndeshjen e radhës në kampionat dhe më pas për ndeshjen e kthimit që do të luajmë në shtëpi dhe do ta kemi edhe mbështetjen e publikut

tonë. Është e vështirë të luash në fushë sintetike. Fusha është më e fortë, topi lëviz më shpejt dhe sigurisht që ata janë mësuar në këtë terren pasi luajnë gjithmonë këtu. Por nuk duhet të gjejmë justifikime. Duhet të përshtatshim më mirë", ka shtuar mbrojtësi shqiptar.



Infantino, Ademi: Do të vazhdojmë të punojmë së bashku për rritjen e futbollit në Kosovë

PRISHTINE, 8 PRILL - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, e ka uruar presidentin Agim Ademi me rastin e rizgjedhjes së tij për mandatin e dytë në krye të FFK-së. Në telegramin e urimit i pari i FIFA-s i shpreh urimet më të sinqerta Ademi, duke e falënderuar për të gjitha përpjekjet, punën dhe kontributin e tij të rëndësishëm për zhvillimin dhe promovimin e futbollit dhe vlerave të këtij sporti. "I nderuar president, i dashur Agim, ju lutemi pranoni përshëndetjet e mia më të përzemërta dhe urimet më të sinqerta për rizgjedhjen tuaj president i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) në Kuvendin e Përgjithshëm Zgjedhor të FFK-së, të mbajtur dje në Prishtinë. Shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për të gjitha përpjekjet, punën



dhe kontributin tuaj të rëndësishëm për zhvillimin e sportit tonë dhe promovimin e vlerave të tij në Kosovë. Ju dërgoj juve dhe ekipit tuaj urimet më të mira për këtë mandat të ri dhe çdo sukses për të gjitha sfidat që

janë përpara. I nderuar president, pres të vazhdoj të punoj me ju për rritjen dhe prosperitetin e futbollit në Kosovë në vitet në vijim", thuhet në letrën e urimit të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino.

Kampionët e Bucksit fitojnë duelin ndaj Bostonit

MILWAUKEE, 8 PRILL - Beteja për kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes bëhet e fortë në sfidat e fundit të sezonit të rregullt. Milwaukee ngjitet në vendin e dytë pas fitores me rezultat 127-121 ndaj Bostonit, dy epike që kanë të njëjtin numër fitoresh, 50. Antetokounmpo dhe Holiday realizuan të dy nga 29 pikë për kampionët e Bucksit. Golden State është forca e tretë në Perëndim, duke mundur me shifrat 128-112 lakersat, tashmë



të eliminuar nga gara "play-off". Tucker realizoi 40 pikë për lakersat, por që mbeten për statistikë, ndërsa për Warriorsin u dallua Thompsoni me 33 pikë. Fitoi edhe Denveri, që falë 35 pikëve e 16 reboundeve të Nikola Jokiqit, mundi me shifrat 122-

109 Memphisin. Zhgënjën Philadelphia, që u mund me rezultat 119-114 në fushën e Torontos. Për kanadezët u dalluan Siakam me 37 pikë e Trenti me 30, duke i bërë të pavlefshme 30 pikët e Embiidit për miqtë.

REZULTATET

Charlotte - Orlando	128-101
Milwaukee - Boston	127-121
Toronto - Philadelphia	119-114
Minnesota - San Antonio	127-121
New Orleans - Portland	127-94
Denver - Memphis	122-109
Golden State - Lakers	128-112

SHKURT

Xavi: Morëm rezultat të mirë ndaj Frankfurtit

Trajneri i skuadrës së Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë se skuadra e tij ngeci në qarkullimin e topit në ndeshjen ndaj Eintracht Frankfurtit (1-1). Ai pati ankesa edhe për fushën e blertë, derisa është i kënaqur me rezultatin e arritur. "Është rival i vështirë, i mirë fizikisht. Lojtarët dilnin mirë në kundërsulm dhe ne nuk dimim t'i ndalnim ato sulme në tranzicion. Ne nuk kemi qenë të mirë as në qarkullimin e topit. Fusha nuk ishte e mirë, por morëm rezultat të mirë. Në Evropë gjithçka është e barabartë. Eintracht është dhe do të jetë i komplikuar", ka thënë Xavi Hernandez.

Courtois: Një gol mund t'ia rikthejë besimin Chelseat

Pas fitores 1-3 ndaj Chelseat në "Stamford Bridge" për çerekfinalen e parë të Ligës së Kampionëve, portieri i Real Madridit, Thibaut Courtois, ka paralajmëruar shokët e skuadrës së tij se duhet të tregohen më të kujdesshëm në ndeshjen e kthimit. Duke folur pas fitores, Courtois theksoi se vetëm një gol në takimin e radhës mund t'ia rikthejë besimin Chelseat. "Morëm një rezultat të mirë në një fushë të vështirë, duke e pozicionuar veten tonë mirë për ndeshjen e kthimit. Por ende nuk kemi arritur në gjysmëfinale. Nuk kemi bërë ende asgjë, pasi një gol në minutat e para të takimit që do të luhet në 'Bernabeu' mund t'i rikthejë energjinë dhe besimin Chelseat", ka thënë Courtois.

Reali, Liverpooli dhe Juve, në garë për Gnabryn

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Serge Gnabry, është një nga lojtarët që pëlqehet nga shumë klube të mëdha evropiane. Fillimisht Liverpooli dhe Real Madridi kanë shprehur interesim për anëtarin e Bayernit, derisa garës i është shtuar edhe Juventus. Lajmi është bërë me dije nga mediumi "Fichajes". Çmimi i 26-vjeçarit vlerësohet të jetë 70 milionë euro, por me vetëm një vit kontratë, ky çmim mund të ulët dukshëm.

Gjashtë lojtarë do të largohen në verë nga Unitedi

Manchester Unitedi pritet të ndahet me gjashtë lojtarë në afatin kalimtar të verës. "The Mirror" raporton se Unitedi do ta lejojë largimin e Paul Pogbas, Jesse Lingardit, Edinson Cavanit, Juan Matas, Tahith Chongut dhe Lee Grantit. E ardhmja e Cristiano Ronaldos është gjithashtu e pasigurt, me Unitedin që duket se do ta humbasë vendin e katërdhës të futbollit në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Edhe e ardhmja e Marcus Rashfordit mbetet në dyshim. Por, Unitedi i ka thënë skuadrës se ata lojtarë që mbeten nën kontratë nuk do të lejohen të largohen për shkak të atyre që tashmë largohen me skadimin e kontratave. Të tjerë, si Anthony Martial, Donny van de Beek, Dean Henderson, Phil Jones, Axel Tuanzebe dhe Eric Bailly, janë nën kontratë, por mund të largohen ose huazohen për të fituar diku kohë të rregullt të lojës.

Evertoni rrezikon rënien, kërkohet shkarkimi i Lampardit

Aventura e Franck Lampardit në bankinën e Evertonit është drejt fundit, pasi rezultatet kanë qenë shumë larg pritshmërive dhe tashmë "Toffees" rrezikon

seriozisht rënien nga kategoria. Tekniku londinez mori drejtimin e ekipit nga Liverpooli në fund të muajit janar, megjithatë në nëntë ndeshje në kampionat ka

marrë vetëm 6 pikë, pasi skuadra ka regjistruar dy fitore dhe plot 7 humbje. Aktualisht Evertoni mban vendin e 17 me 25 pikë, një më tepër se Burnley që

plotëson zonën e rënies, megjithatë tashmë askush nuk beson më te Lampardi dhe ish-sulmuesi Victor Anichebe ka dalë hapur, duke kërkuar shkarkimin e

trajnerit. Ndërkohë edhe tifozët e Evertonit nuk e kanë fshehur zhgënjimin në rrjetet sociale, madje kanë nisur ta kërkojnë rikthimin e Sam Allardyce në bankinë.



Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"

38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereze.org e-mail:ntereze@yahoo.com

NJOFTIM PËR KONTRATË SHËRBIME

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 08/04/2022

Nr i Prokurimit	Transport	001	2022	221
-----------------	-----------	-----	------	-----

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"	
Adresa Postare: Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1	
Qyteti Prishtinë	Kodi postar: 10000
Vendi: Kosovë	
Personi kontaktues: Zef Shala	Telefoni: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com	Faksi: 038-542-869
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):	www.motherteresasociety.org

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Jo

Nëse po, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:	
Shërbime të transportit ndërkombëtar	
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime - e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)	
<input type="checkbox"/>	Shërbime

Formulari standard: "Njoftimi për Kontratë"

Shërbime transporti ndërkombëtar	
Vendi kryesor i realizimit Relacioni Prishtinë-pika kufitare Rumani-Ukrainë dhe anasjelltas	

II.1.3) Njoftimi përfshinë	
Krijimin e kontratës publike kornizë	Jo <input type="checkbox"/>

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Shërbime të transportit ndërkombëtarë ne relacionin Prishtinë-Pika Kufitare Rumani-Ukrainë me artikuj ushqimor, joushqimorë, hygienikë. Pesha maksimale 25 tonë ndihmash humanitare te gjitha prodhime vendore te paketuara me paleta përkatëse sipas standardeve ndërkombëtare	
--	--

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 60.00.00.00-8	
--	--

II.1.7) Variantet pranohen	Jo <input type="checkbox"/>
----------------------------	-----------------------------

II.1.8) Ndarja në Pjesë	Jo <input type="checkbox"/>
-------------------------	-----------------------------

II.1.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve (nëse aplikohet):	Nukë aplikohet
---	----------------

II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen) nukë aplikohet
--

II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: 20,000.00 Euro (4 kamion)

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Vetëm Shërbime të transportit

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj Një apo mbrenda 30 ditëve_ (nga nënshkrimi i kontratës)
apo
Fillimi 20/04/2022
Përfundimi 20/05/2022

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit	Jo <input type="checkbox"/>
--	-----------------------------

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

Nuk aplikohet

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës; Nuk aplikohen

Jo

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshme: Administrative

1. Certifikata e Regjistrimit të biznesit-Transport ndërkombëtar
2. Certifikatën e Numrit fiskal
3. Vërtetimin tatimor nga ATK (vetëm për fituesin e kontratës), ku vrehet se OE i ka përbush obligimet nga tremujori i fundit ose i ka te programuara me rata obligimet e mbetura
4. Vërtetim nga Gjykata Themelore (vetëm për fituesin e kontrates) ku shifet se Kompanija dhe pronari i saj nuke jane ne ndonje procedur gjygsore

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Dokumenti unik nga Ministria përkatëse
2. Dokumenti unik nga Institucioni përkatës
3. Dokumenti adekuat nga ATK-ja (vetëm për fituesin e kontrates)
4. Dokumenti adekuat nga Gjykata themelore (vetëm për fituesin e kontrates)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Staf i profesional-Shofer të licensuar për transport ndërkombëtar

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Patent shoferi adekuat për transport nderkombëtar.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Përvoja e gjertanishme ne tri vitet e fundit ne transporte nderkombetare

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kontrata apo Referenca adekuate

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Kamion te regjistruar kapaciteti 25 tonësh adekuat per transport nderkombetar

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Dokumenti unik-Leja e qarkullimit te automjeteve

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nukë aplikohet Jo

III.3.2) Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës	
<input type="checkbox"/>	E hapur
IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata) Nukë aplikohet	
IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata) Nukë aplikohet	
IV.1.4) Numri minimal i kandidatëve të cilët do të ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është : Nukë aplikohet	

IV.2) KRITERET E DHËNIES

<input type="checkbox"/>	Çmimi më i ulët
--------------------------	-----------------

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Jo

IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për [dosjen e tenderit] : data 13/04/2022

Dokumentet me pages Jo

IV.3.3) Afati i fundit për pranimit të tenderëve

data 15/04/2022 koha 12.00 vendi Prishtinë

IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:

jo

IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Jo

IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: nga data: 15/04/2022 ditë 30 apo muaj - Nje

IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 15/04/2022 koha 14.00 vendi Prishtinë

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe,

Formulari standard: "Njoftimi për Kontratë"



Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereza"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"

38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani p.n. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereze.org e_mail:ntereze@yahoo.com

NJOFTIM PËR KONTRATË FURNIZIM

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 08/04/2022

Nr i Prokurimit	Ukraina	001	2022	121
-----------------	---------	-----	------	-----

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip Serbisht Anglisht

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Shoqata Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Nëna Tereza"		
Adresa Postare: Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1		
Qyteti Prishtinë	Kodi postar: 10000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Zef Shala		Telefoni: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com		Faksi: 038-542-869
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		www.matherteresasociety.org

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Jo

Nëse po, specifikoj identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Furnizim me artikuj Ushqimor dhe Joushqimor Made in Kosova (Prodhime Vendore)

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime - e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Furnizime	
<input type="checkbox"/> Blerja	
Vendi kryesor i dorëzimit Sias kërkesës së Autoritetit Kontraktues	

II.1.3) Njoftimi përfshinë
Krijimin e kontratës publike kornizë Jo

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet): Nukë Aplikohet

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Furnizim me artikuj Ushqimor dhe Joushqimor te gjitha prodhime vendore pra te prodhuara ne Kosovë me shenjen MADE IN KOSOVA
Të gjitha prodhimet duhet te disponojnë me çertifikatë kualiteti si dhe çertifikaten FITO-SANITARE mvarsisht nga produkti qe ofron (dokument zyrtar nga AVUK)

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):
15.00.00.00-8

II.1.7) Variantet pranohen Jo

II.1.8) Ndarja në pjesë Po

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)
 vetëm një pjesë

II.1.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve (nëse aplikohet):
Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:
të gjitha pjesët nëse i plotëson kushtet ofertuese sipas DT

II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohet)

Nr. i pjesës	Përshkrimi i shkurtër
L-1	Furnizim me Miell paketimi 1/1 prodhim vendor tip 400 shuma e mjeteve te parapara 15,000.00 Euro
L-2	Dyshek për një person dimensiononi 200x90 1 mbështjellë me pëlhurë 55 % PES, 45 % PP, 120 gsm Syngjer 25 kg/m3-10 cm Singjir ne tri anet shuma e mjeteve te

	parapara 20,000.00 Euro
	Jastëk Klasik Pëlhur e bardhë 100 % poliester Mbushja 70 % memorie dhe 30 % shkumë standarde Pa zingjir Jo alergjik dhe kunder pluhurit Shuma e mjeteve te parapara 1,000.00 Euro
L-3	Vaj Luledielli paketimi (900 ml) 1/1 prodhim vendor
	Ujë natyral nga burimet vendore paketimi 6/1
	Pasta-Makaronat paketimi 0.500 gr, prodhim vendor
	Supë pule paketimi 65 gr. Prodhim vendor
	Biskota keks paketimi 8*320 gr prodhim vendor
	Pire paketim 300 gr. Prodhim vendor
	Marmeladë kumbulle 880gr prodhim paketim paketim qelqi
	Oriz paketimi 8*800 gr. Prodhim vendor
	Sapuna të lëngshëm për duar 500 ml prodhim vendor
	Leter Tualeti paketim 10/1 prodhim vendor
	Paloma të lagëta (familjare 16*100 pcs) prodhim vendor
	Antibacterial Hand Gel Sanitizes 100 ml prodhim vendor
	Shpageta 14 Linguine 400 gr
	Shuma e parapare e ketij Lloti 40.000.00 Euro

II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: për të gjitha Llotet 76,000.00 Euro

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Prodhime vendore te legjitimuara nga Institucionet perkatese duke plotësuar edhe kriteret kualitative si edhe ato fitosanitare – Dokumentuar nga te gjithë Operatorët Ekonomik te cilet konkurojn per cilin do artikull te llotit perkatese

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj NJE apo ditë 30 (nga nënshkrimi i kontratës)
apo
Fillimi 20/04/2022
Përfundimi 20/05/2022 (dd/mm/vvv)

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit	Jo <input type="checkbox"/>
III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet): Nukë aplikohet	
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës	Jo <input type="checkbox"/>

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
1. Certifikata e Regjistrimit të biznesit-Transport ndërkombëtar
2. Certifikaten e Numrit fiskal
3. Vërtetimin tatimor nga ATK (vetëm për fituesin e kontratës), ku vrehet se OE i ka përbush obligimet nga tremujori i fundit ose i ka te programuara me rata obligimet e mbetura
4. Vërtetim nga Gjykata Themelore (vetëm për fituesin e kontrates) ku shifet se Kompanija dhe pronari i saj nuke jane ne ndonje procedur gjygsore

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Dokumenti unik nga Ministria përkatëse
2. Dokumenti unik nga Institucioni përkatës
3. Dokumenti adekuat nga ATK-ja (vetem per fituesin e kontrates)
4. Dokumenti adekuat nga Gjykata themelore (vetem per fituesin e kontrates)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Stafit profesional-menagjerial i Kompanisë- Organogrami
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
ICV-te e stafit Menagjerial

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Përvoja e gjertanishme ne tri vitet e fundit ne punë të ngjashme
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Kontrata apo Referenca adekuate

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar Jo

III.3.2) Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve Po

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

 E hapur

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociatave)

IV.1.4) Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftoheshin që të dorëzojnë

Tenderët fillestar është : Nukë aplikohet

IV.2) KRITERET E DHËNIES

 Çmimi më i ulët

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë Jo

IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për [dosjen e tenderit] : data 13/04/2022

Dokumentet me pages Jo

IV.3.3) Afati i fundit për praninë të tenderëve

data 15/04/2022 koha 12.00 vendi Prishtinë

IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:

 jo

IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Jo

IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: nga data: 15/04/2022 ditë 30 apo muaj Një

IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 15/04/2022 koha 14.00 vendi Prishtinë

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, vizita në punishte etj]

Formulari standard: "Njoftimi për Kontratë"

5

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
ODRASLE

AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër:258/1

Datë: 08.04.2022

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 30.03.2022 me nr. 1821 së QK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të QK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjencionit turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencionit duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencionit duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencionit duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencionit turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencionit duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (KDSH ka preferuar javën e dytë të muajit Maj me datë 07,08,09,10,11.05.2022-katër netë).
- Agjencionit duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencionit turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencionit duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencionit duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencionit do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2020-2021-2022)
- Agjencionit duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulësve dhe targa të autobusit që do të vozisin.
- Agjencionit duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskurzion.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvarësisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskurzion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencionit të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutjesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfë të vogël oferta e mbyllur e futur në zarfë të madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyrën e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërtesa MASH-t-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë) Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Merita Haxhosaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. të mjekësisë "Hysni Zajmi".

► "Blu Farm" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit si dhe të TVSH-së, me nrb. 810833089 nr. të TVSH-së, 330212605.

► Shefqet Gani Sahiti nga Panorci kk Malishevë shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" me nr. 79.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vives", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 265/1
Datë: 08.04.2022

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016 shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendrës së Kompetencës-Ferizaj, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (**KDSH ka preferuar javën e parë të muajit Maj me datë 05.06.05.2022-dy net**).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2020-2021-2022)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- *Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,*
- *Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,*
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo,*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),*
- *Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.*

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje te shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërtesa MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë) Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus nje ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 259/1
Datë: 08.04.2022

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 17.03.2022 të shkollës QK “11 Marsi”, në Prizren shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të QK “11 MARSII” në Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (**KA të klasëve të 12-ta e ka preferuar 04.05.2022 deri më 08.05.2022**)
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2019-2020-2021)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- *Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,*
- *Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,*
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo,*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),*
- *Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrësi i vjetër, Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.*

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi më i ulët ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje te shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërtesa MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë) Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus nje ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues